

Tribunë publike në Dibër „Festat fetare – ura për afrimin e bashkësive etnike”

Më 25 shtator të vitit 2008 gjatë agjërimeve të Ramazanit, në Dibër u mbajt tribunë publike me temë “Festat fetare – ura për afrimin e bashkësive etnike”. Në tribunë morën pjesë gjithsej 152 pjesëmarrës, përfaqësues të organizatave joqeveritare (97), përfaqësues të pushtetit lokal dhe institucioneve lokale (31), gazetarë (9), përfaqësues të bashkësive lokale fetare (4) dhe qytetarë nga komunat e Dibrës, Qendrës Zhupë dhe Rostushë (11). Qëllimi i tribunës publike ishte të përfordhet jetesa multietnike në rajon, të shkëmbehen dituri të ndërsjella për doket/festat krishtere dhe myslimane, njëkohësisht të iniciohet krijimi i rrjeteve mes organizatave joqeveritare. Tribunën e udhëhoqi Ilir Iseni, avokat dhe kryetar i organizatës rinore “Rini tolerante” në Dibër.

Në fillim të tribunës u organizua darkë tradicionale Ramazani (iftar) për pjesëmarrësit me meny Dibre. Pas darkës së përbashkët vijoi një prezantim i shkurtë i projektit.

Në vazhdim të tribunës, fjalim mbajti Ruzhdi Lata, përfaqësues i bashkësisë fetare islamike, i cili dha një retrospektivë historike për tolerancën fetare në Dibër, praktikimi i tolerancës në jetën e përditshme dhe toleranca fetare te Shqiptarët gjatë historisë. Ai ceku se në Dibër ka të ndërtuar tolerancë të mirë mes bashkësive etnike dhe respektimin e përkatësisë religjioze, kjo rrallë ndodhën në qytetet tjera. Numëruan shembuj nga e kaluara për atë si është ruajtur bashkëjetesa, solidariteti mes shqiptarëve dhe maqedonasve, si edhe mes bashkësive tjera etnike të përkatësisë fetare të ndryshme. Në tribunë në veçanti u përshëndetën besimtarët krishterë të cilët tregojnë respekt ndaj besimtarëve islam në Dibër. Në fund të fjalimit të vet ai i falënderua organizatorit të tribunës dhe darkës dhe e vlerësoi si shembull për afrim konkret i cili synon integrimin evropian.

Blagoja Spiroski, përfaqësues i bashkësisë krishtere fetare ua uroi të pranishmëve festën e Ramazanit dhe e shprehu kënaqësinë e vet nga bashkëjetesa që e ka pa në Dibër dhe respektimin e ndërsjellë i cili ekziston te të gjithë qytetarët. Të pranishmëve u rekomandoi me kujdes ta ruajnë ndjenjën e tolerancës, e cila historikisht është e pranishme në Dibër dhe fëmijët e tyre ti edukojnë në frymën e dashurisë dhe respektit ndaj të gjithëve. Njëkohësisht ai i numëroi festat krishtere të cilat janë të ngjashme me ato islamiket, agjërimet të cilat tregojnë ngjashmëri, mesazhet e festave siç janë Pashkët. Në fund të fjalimit ai u dëshiroi fat dhe shëndet të gjithëve dhe në të ardhmen të mblidhen përsëri, të jetojnë në dashuri dhe tolerancë si bashkësi fetare dhe multietnike.

Dr. Ilber Kokalle, mjek specialist dhe drejtor i spitalit të qytetit në Dibër sqaroi si është agjëruar në të kaluarën duke filluar nga egjiptianët e vjetër, grekët e vjetër, filozofët, mjekët e vjetër dhe rusët e deri sot. Ai theksoi se pacientët agjërimin e përjetojnë si një pastrim të organizmit, kurse në disa klinika përdoret si terapi për shërim. Pjesëmarrësi i porositi që agjërimin mos ta kuptojnë si pengesë në punë dhe mësim, kurse fëmijët duhet të ushqehen si zakonisht që të mundën ta ndjekin mësimin dhe të mësojnë. Të moshuarit dhe të sëmurit që përdorin terapia nuk u rekomandohet të agjërojnë, si edhe nënave dhe foshnjave. Në fund të tribunës kishte disa deklarata pozitive dhe rekomandime për organizime më të shpeshta të takimeve të këtilla nëpërmjet cilëve do të avancohet bashkëjetesa multietnike në rajon dhe qytetarët do të jetojnë në harmoni dhe mirëkuptim duke u dhënë shembull të gjithëve. Tribunën e organizoi Fondacioni Instituti Shoqëria e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me Qendrën për zhvillim të qëndrueshëm të bashkësisë Dibër (ish Qendra për përkrahjen e OJQ-ve).